



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prijeto / Prodato Received / Delivered	22.08.2023	3 viti god year	
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHMSHCK	5773	2023	1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic o Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE O KOSOVA

A.nr.1004/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës -Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Çlirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.1004/2023 të datës 18.07.2023 të parashtruar nga ankuesi, [redacted] të cilët me autorizim i përfaqëson [redacted] me adresë [redacted]

[redacted] kundër organit të punësimit Agjencia Kadastrale e Kosovës-Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike "Shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 22.08.2023, morri këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.nr.1004/2023 e datës 18.07.2023 e parashtruar nga [redacted] grup ankuesish.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil [redacted] i punësuar në Agjencinë Kadastrale të Kosovës sipas Akt Emërimit të datës 11.01.2012, Nëpunësja civile [redacted] e punësuar në Agjencinë Kadastrale të Kosovës sipas Akt Emërimit të datës 11.01.2012, Nëpunësi civil [redacted] i punësuar në Agjencinë Kadastrale të Kosovës sipas Akt Emërimit të datës 11.01.2012 dhe Nëpunësi civil [redacted] i punësuar në Agjencinë Kadastrale të Kosovës sipas Akt Emërimit të datës 11.02.2012 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër veprimit administrativ të Agjencisë Kadastrale të Kosovës -Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës lidhur me kategorizimin e pozitës së tyre në Kategorinë Profesionale 2.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 28.07.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, ndërsa me datë 02.08.2023 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore, konstatoi se ankesa e [redacted] grup ankuesish është e palejuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht Akt e Emërimit e datës 11.01.2012, rezulton se ankuesi [redacted] është i punësuar në pozitën e punës "Ekspert i GIS-it", në Drejtoratin e Kadastrit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, pranë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me koeficient të pagës shtatë (7), sipas sistemit të vjetër të pagave, ankuesja [redacted] është e punësuar në pozitën e punës "Ekspert Kadastral", në Drejtoratin e Kadastrit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, pranë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me koeficient të pagës shtatë (7), sipas sistemit të vjetër të pagave, ankuesi [redacted] është i punësuar në pozitën e punës "Ekspert i Matjes", në Drejtoratin e Matjes të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, pranë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me koeficient të pagës shtatë (7), sipas sistemit të vjetër të pagave dhe ankuesi [redacted] është i punësuar në pozitën e punës "Ekspert i GIS-it", në Drejtoratin e Kadastrit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, pranë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me koeficient të pagës shtatë (7), sipas sistemit të vjetër të pagave.

Ankuesit, me datë 18.07.2023 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se Agjencia Kadastrale e Kosovës pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i ka kategorizuar ankuesit në Kategorinë Profesionale 2, me koeficienti të pagës pesë pikë një (5.1), ndërsa të njëjtit kanë kërkuar ndryshimin nga kategoria aktuale në Kategorinë Specialist i Gjeodezisë, me koeficient të pagës shtatë (7).

Institucioni përkatësisht, Agjencia Kadastrale e Kosovës ka dërguar kërkesën në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë-MPB, kërkesën për korrigjimin e koeficienteve të pagave që lidhet edhe me pretendimet ankimore të ankuesve.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesve, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2 paragrafi 1 në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: "1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj", dhe nenin 14 paragrafi 3 të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe si rrjedhojë, referuar këtij përcaktimi ligjor Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e përcaktuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët

publik, në këtë rast në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit nga analizim i shkresave të lëndës ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Agjencia Kadastrale e Kosovës/Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procesimi i pozitive të ankuesve në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së saj të punës në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i ekuivalencës së sistemit të vjetër me sistemin e ri të koeficienteve të përcaktuar me Vendimin Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, duke qenë se me nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe më pikën 5 dhe 6 të Vendimit VNr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, institucionet e administratës publike janë obliguar që të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitive të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se nëntë (9) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, gjegjësisht deri me datë 30.09.2023, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e ankuesve lidhur me kategorizimin e pozitës së tyre në kategorinë *Profesional 2* është e parakohshme dhe si e tillë në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritore, rrjedhimisht e njëjta është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.


Kolegji i Këshillit, theksuar si më sipër, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitive të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës dhe afatit të theksuar më lartë, ankuesve i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankimit lidhur me klasifikimin e pozitës së tyre të punës.

Kështu që mbështetur në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar Vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1004/2023.

Çlirim Zeka

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit [redacted] grup ankuesish;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kadastrale të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.